

V E N D I M
Nr.47, datë 28.1 1999

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Avni Shehu	Kryetar
Agim Shkupi	Anëtar
Natasha Sheshi	“
Vitore Tusha	“
Vangjel Kosta	“
Petrit Plloçi	“
Agim Gjoleka	“
Metush Saraçi	“
Valentina Kondili	“
Vladimir Metani	“
Vladimir Bineri	“
Zamir Poda	“
Bashkim Caka	“
Tefta Zaka	“

Në seancën gjyqësore të datës 28.1.1999 mori në shqyrtim çështjen penale nr. 144/2 që i përket :

TË PANDEHURIT: Astrit Kallajxhi përfaqësuar nga mbrojtësi Gëzim Haderaj.

AKUZA: Vrasje me dashje neni 83 i Kodit Penal.

Gjykata e rrethit Kuçovë me vendimin nr. 12 datë 30.4.1998 ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Andriko Guveli, Astrit Kallajxhi për veprën penale të vrasjes me dashje të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal e në bazë të tij e dënon me 10 vjet burg.

Gjykata e apelit Vlorë me vendimin nr.24, datë 12.6.1998 ka vendosur:

Mospranimin e ankimit në shkallë të dytë.

Kundër vendimit të gjykatës së Apelit Vlorë ka bërë rekurs mbrojtësi i të gjykuarit duke parashtruar këto shkaqe:

Mospranimi i rekursit nuk është i drejtë. Avokati i mbrojtësit i caktuar kryesisht ankimin e ka të bazuar dhe me kërkesën e të afërmeve të tij.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjuan relacionin e anëtarit Vladimir Bineri, prokurorin Arqile Lole, i cili u shpreh se ankimi duhej pranuar nga Gjykata e Apelit Vlorë. Mbrojtësi i caktuar kryesisht gëzon të drejta të plota.

V Ë R E N:

Astrit Kallajxhi është gjykuar nga Gjykata e Rrethit Kuçovë në mungesë.

Kjo gjykatë i ka caktuar kryesisht si mbrojtës avokaten Mimoza Brahimi

Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Kuçovë mbrojtësja Mimoza Brahimi ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë. Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.24, datë 12.6.1998 ka vendosur mospranimin e ankimit me arsyetimin se sipas nenit 420/b të Kodit të Pr.Penale mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar në format e parashikuara nga ligji.

Kolegji Penal i kësaj gjykate për të unifikuar praktikën gjyqësore ia kaloi çështjen për

shqyrtim Kolegjeve të Bashkuara, të cilët pasi diskutuan çështjen arritën në përfundimin se sipas nenit 64 të Kodit civil caktimi ngagjykata kryesisht e mbrojtësit i jep këtij të fundit të drejtë të përfaqësoje të pandehurin sikur të ishte vetë ky i fundit.

Vendimi i marrë nga gjykata është akt i përfaqësimit të lëshuar në format e parashikuara nga ligji (neni 410/2 I Kodit Pr. Penale e 64 të Kodit Civil).

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 441/1 të K.Pr.Penale.

V E N D O S Ë N

Prishjen e vendimit të gjykatës së Apelit Vlorë dhe kthimin e akteve për rishqyrtim po në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Tiranë më 28.1 1999